

# QYTETARËT PËR NDRYSHIM

JANAR - PRILL 2020 // CIVICAMOBILITAS.MK

BULETIN NR.4



## ORGANIZATAT QYTETARE PËRSËRI TREGUAN SE PËRSHTATEN MË GJENDJE EMERGJENCE

Dy muaj në gjendje emergjence dhe pak më shumë nën presion të virusit të ri korona, na imponoi rregulla të reja të sjelljes, forma të reja të punës dhe komunikimit, prioritetet të reja jetësore dhe profesionale. Gjithçka fillon dhe përfundon me Covid-19. Në ambient përpikemi që ta imponojmë normalitetin e tillë nga aktivitetet, perceptimet, pritjet tona, nga jeta jonë.

Edhe në këtë numër të Qytetarët për ndryshime është përgatitur në atë mënyrë. Fillimisht me qëllim që t'i kushtohet pjesëmarrjes qytetare, në ecje u arrit nga Covid-19, që në fund të paraqitet para jush si kombinim i të dyjave, ndërsa në vëllim dhe kornizë kohore pak më l madh nga e zakonshmja.

Organizatave qytetare edhe në këtë gjendje emergjence u organizuan dhe qëndruan në radhët e para që t'u ndihmojnë qytetarëve, atyre që më së shumti kanë nevojë për ndihmë. Përgjigja e parë ishte ndihma humanitare për pleqtë, për të pastrehët dhe për kategoritë tjera të rrezikuara. Por, ndihma nuk ishte vetëm në ushqim dhe mjete higjienike, një pjesë e organizatave u organizuan dhe siguruan ose përpunuan maska mbrojtëse, së pari për punëtorët shëndetësor, pastaj edhe për qytetarët tjerë. Kryqi i Kuq, banka për ushqim, Veprat e vërteta a mirësi, Hera, LGBT Junajted, Hëna, Fokus, Svetla idnina, Star-star janë vetëm disa nga organizatat të cilat distribuon ndihmë humanitare. Listën e organizatave qytetare të cilën e publikoi Civika mobilitas në ueb faqen e vet shënon mbi 180 aksione për ndihmë humanitare, ku ndihma matet me qindra tonë. Kjo listë e quajtur Covid 19 çdo ditë azhurnohet, e krahas ndihmës humanitare, këtu janë edhe aktivitetet lidhur me të drejtat e punëtorëve, fëmijëve dhe të rinjve, shëndetit etj. Secili në fushën e vet të ekspertizës e jep kontributin e vet, për tejkalim sa më të padhembshëm të kushteve të jashtëzakonshme në të cilat u gjet shoqëria.

Numri i katërt i Qytetarët për ndryshime sjell edhe informata për platformën resurse të Evrotink, e cila duhet të sigurojë informim dhe edukim të vazhdueshëm

për integrimet në BE, që do ta lehtësojë inkuadrimitin e qytetarëve në këto procese, për rezultatet nga hulumtimi i Institutit për shkencë shoqërore dhe humaniste kushtuar polarizimit të shoqërisë maqedonase, për inkuadrimitin e kërkesave të romëve në programet e partive politike, për “Engejxh” të fundit për rastin “Dhoma publike”, për marshin për të drejtat e femrës, për Forum teatrin si mënyrë për ndërtimin e vetëdijes dhe luftën kundër dhunës adoleshente dhe shumë të tjera.

Civika mobilitas, për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme të funksionimit, publikoi thirrje dhe më 30 prill ndau gjithsej 15 ad-hok grante për organizata qytetare, të cilat do të zbatojnë aktivitetet lidhur me Covid-19. Vazhdimisht i motivojmë organizatat qytetare t'i ndajnë aktivitetet e tyre lidhur me pandeminë, të cilat pastaj i publikojmë në ueb faqe dhe në buletin e jashtëzakonshëm. Informatat janë të rëndësishme në momente të tilla, por jo të lavdërohem se u jemi përgjigjur nevojave dhe kërkesave të qytetarëve, por t'i bëni aktivitetet tona më të kapshme për ata të cilët kanë nevojë për ato.

Dhe në fund, por jo edhe më pak e rëndësishme, vëzhgimi i zgjuar i vendimeve të autoriteteve kushtuar luftës për mbrojtjen e atyre, të drejtat e të cilëve janë shkelur dhe solli fitore të koalicionit prej 11 organizatave qytetare të cilat e bindën Qeverinë që ta ndryshojë vendimin me të cilin mundësohej largimi i punëtorëve në firmat të cilat shfrytëzojnë mbështetje shtetërore në tejkalimin e pasojave ekonomike të shkaktuara nga pandemia. “Vazhdojmë të veprojmë të bashkuar”, thonë ata në kumtesën e tyre, “sepse vetëm kështu mund të ndërtojmë shoqëri të drejtë, solidare dhe humane”. Na vjen mirë që një pjesë e këtyre organizatave janë pjesë e komunitetit të madh të Civika mobilitas.



TEMA  
**COVID-19**

# Vullnetarët e Kryqit të Kuq në terren gjatë koronavirusit



Kryqi i Kuq që nga paraqitja e korona virusit në shtetin tonë është i pranishëm mes popullatës me aktivitete parandaluese, si dhe ndihmë dhe mbështetje kategorive më të rrezikuara të popullatës.

Në 15 qytete janë formuar ekipe mobile të cilat janë aktive çdo ditë dhe detyra e të cilëve është të kryejnë furnizim të domosdoshëm të ilaçeve, prodhimeve ushqimore dhe mjeteve për higjienë personale dhe të njëjtat i dorëzojnë deri te shtëpia e pleqve, personave të cilët jetojnë vetë, të sëmurëve kronik, deri te familjet me persona me nevoja të veçanta, prindërve të vetëm dhe kategorive tjera të rrezikuara të qytetarëve.

Ekipet mobile janë përbërë prej personave për përgjigje gjatë katastrofave dhe personave të trajnuar për ofrimin e ndihmës së parë mjekësore. Shërbimi i servisit që e sigurojnë ekipet mobile është pa pagesë, ndërsa qytetarët duhet të ndajnë mjete financiare vetëm për artikujt ose ilaçet të cilat duhet të blihen. Qëllimi i këtij aktiviteti është t'u mundësohet mbështetje personave të cilët kanë nevojë më së shumti, me çka ata nuk do të kenë nevojë të dalin nga shtëpitë e tyre dhe në këtë mënyrë do të zvogëlohet rreziku nga infektimi me virusin Kovid-19 (korona virusin).

Po ashtu bëhet distribuimi i ndihmës humanitare për të pastrehët dhe realizohet fushata për ngritjen e vetëdijes përmes distribuimit të posterëve për promovimin e higjienës dhe mbrojtjes nga korona virusi.

OKKK/KKQSH	Numri për kontakt	Korniza kohore e funksionimit
Manastir	047 236 019	08 – 12:00
Veles	078 254 729, 075 272 485, 075 247 637	08 – 18:00
Gazi Babë	071 243 078, 02 2529 153	08:30 – 12:30
Dellçevë	033 412 010	09 – 13:00
Kavadar	070 239 352	08:30 – 12:00
Karposh	071 349 230, 02 3068 806	08:30 – 12:30
Kisella Vodë	071 349 225, 02 3211 417	08:30 – 12:30
Kërçovë	045 225 324	08:30 – 12:00
Koçanë	071 373 677	09 – 14:00
Krushevë	071 379 920	08 – 12:00
Ohër	046 261 909, 070 315 309, 13 112 (numri i shkurtuar i telefonit i Shërbimit malor për shpëtim).	08 – 16:00
Sveti Nikole	032 443 171, 074 600 171	08 – 13:00
Strugë	071 398 424	08 – 12:00
Strumicë	071 345 901	10 – 12:00
Tetovë	044 336 374	09 – 15:00
Qendër	070 297 166, 02 3115 029	08:30 – 12:30
Çair	070 208 383, 02 2621 924	08:30 – 12:30
Shtip	074 203 030	08 – 16:00
Kryqi i Kuq i Qytetit të Shkupit – Ekipi për të pastrehët	02 3096 227	08:30 – 12:30

# Vendosja e masave kundër largimit nga puna derisa zgjat kriza

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut ka marrë lajmërimi nga një numër i madh i punëtorëve se disa punëdhënës e keqpërdorin gjendjen e jashtëzakonshme dhe paralajmërojnë pezullim të kontratave për punësim për një grup të madh të punësuarve ose uljen e dukshme të rrogave.

Nga shoqata bëjnë thirrje për moratorium për pezullimin e të gjitha kontratave për punësim dhe të gjitha paralajmërimet për uljen e rrogave.

“Apelojmë deri te punëdhënësit që mos ta shfrytëzojnë këtë periudhë të vështirë për interesa personale, por të inkuadrohen dhe sa mund, të ndihmojnë në tejkalimin e krizës shëndetësore në shtet. Në këto kohë mjaft të paparashikueshme dhe të vështira, mbetja pa pagë për një pjesë të madhe të punëtorëve do të thotë rrezik për ekzistencën e tyre dhe mu për këtë nevojitet solidariteti. Aq më shumë “personat fizik dhe juridik të cilët nuk i respektojnë dhe i shkelin rekomandimet, do të mbajnë përgjegjësi penale në pëlqim me nenet 205 dhe 206 të

Kodit penal”, thuhet në kumtesën.

Po ashtu, në këtë kumtesë bëhet apel që mos të nënshkruajnë asgjë pa konsultime paraprake me jurist dhe/ose avokat.



**Të gjithë ata që ballafaqohen me mosrespektimin e të drejtave të tyre punëtoresh, ata mund ta paraqesin rastin te Inspektorati shtetëror për punë në numrin e telefonit 151 31 ose në Komitetin e Helsinkit për të drejtat e njeriut në numrat 02 319 073, 072 278 436, ose në adresën elektronike [helkom@mhc.org.mk](mailto:helkom@mhc.org.mk)**

## Grupi “Bashkë në shtëpi” i bashkoi familjet

Grupi në Facebook “Bashkë në shtëpi” (Zaedno doma) për momentin numëron 2.500 anëtarë dhe mbi 400 aktivitete zbavitëse, të cilët prindërit dhe kujdestarët i praktikojnë me fëmijët e tyre gjatë vetë izolimit. Me këtë platformë udhëheq Ambasada e parë e fëmijëve në votë “Megjashi” me qëllim që të nxitë kohë kreative dhe cilësore me fëmijët në kushte të pandemisë.

Nga Megjashi thonë se gjendja e krizës shkaktoi regjenerimin e qelizës themelore të shoqërisë, nga e cila nisë çdo gjë, ndërsa grupi i përgjigjet nevojës e cila ekziston mes prindërve. Për ata, është e dukshme bashkimi i familjeve në këtë periudhë, që rezulton me mbështetje të rritur, dashuri, udhëzim i drejt dhe ndenje të sigurisë.

Prindërit dhe fëmijët kreativ ndajnë përmbajtje të ndryshme, mes të cilave aktivitet fizik, veçanërisht për rritjen e aftësive lokomotorike të fëmijët, recitimi i poezive, realizimi i shfaqjeve, krijime artistike etj. Anëtarët e grupit inspirohen mes veti, ndërsa fëmijët fitojnë shkathtësi të reja dhe të çliruar nga brenga për botën e jashtme dhe gjendjen e jashtëzakonshme.

Distanca fizike në këtë gjendje të fëmijët mund t'i rrënjose shprehitë e mira, sjelljet dhe vlerat morale”, shtojnë nga Megjashi. Ata shprehin kënaqësi që grupi funksionon pa nxitje të madhe prej tyre si krijues dhe se anëtarët e kanë pranuar si garë të kreativitetit në përditshmërinë e re.



## Proces transparent i furnizimeve publike urgjente

Qendra për komunikime qytetare përgatiti një analizë të furnizimeve publike urgjente në vend, me qëllim që të ndikohet mbi rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe racionalen e këtyre furnizimeve.

Ligji për furnizime publike lejon që furnizimet urgjente të zbatohen me negociata të drejtpërdrejta me kompanitë, gjegjësisht gjatë kësaj të mos publikohet shpallje, për çka institucionet nuk kanë nevojë për mendim paraprak nga Byroja për furnizime publike. Gjendja e emergjencës, mungesa e përgjithshme e produkteve të domosdoshme dhe shpejtësia me të cilën zbatohen furnizimet e rritin rrezikun nga korrupsioni gjatë zbatimit të kësaj, edhe ashtu procedurë jo transparente për furnizim publik.

Gjetjet kanë treguar se në gjysmën e kontratave të lidhura për furnizime urgjente është negociuar vetëm me një kompani. Nga ana tjetër, çmimet për produkte të ngjashme janë dukshëm të ndryshme varësisht nga ajo nëse institucioni ka negociuar vetëm me një ofertues ose e ka zgjedhur më të volitshmin nga shumica e ofertuesve. Po ashtu, një pjesë e marrëveshjeve të publikuara për furnizime urgjente nuk përmbajnë përshkrim të

hollësishëm për produktet e furnizuara, me çka nuk mund të verifikohet racionalja e mjeteve të shpenzuara.

CGK, grantist institucional i Civika mobilitas, do të vazhdojë t'i ndjekë furnizimet urgjente lidhur me virusin e ri korona që me kohë të detektojë dobësi të caktuara në proces dhe të japë kontribut drejt tejkalimit të tyre, ndërsa me qëllim të shfrytëzimit racional të resurseve të kufizuara publike në vend.



## Distribuimi i ndihmës deri te më nevojtarët

VSS Efekt Koalicioni kundër urisë dhe hedhjes ushqimit dhe Bankës joformale lokale për ushqim Kavadar, me të cilin menaxhon "Eko zhivot", në periudhën e kaluar u inkuadruan në luftën me pasojat nga pandemia. Për këtë qëllim, ata e modifikuan aksionin nga viti i kaluar "Zero uri", që u zhvillua në ato komuna. Nga ana tjetër, veprimi gjatë gjendjes së emergjencës shkaktoi edhe lloje të tjera të përshtatjes në gjithë procesin e pranimit, paketimit dhe distribuimit të ndihmës, të dedikuar për pleqtë, si dhe për familjet me rrezik social.

Për momentin me përkushtim punohet në Shkup dhe Kavadar, ndërsa paralajmëruan edhe zgjerimin e aktiviteteve të tyre humane edhe në Veles. Tani

u ndihmojnë 1.000 shfrytëzuesve me pako sociale. Donacionet që i grumbullojnë numërohen në tonë, që do të thotë se kompanitë dhe individët e njohën punën e tyre dhe në situata krize ua japin besimin me resurset me të cilat disponojnë.

Nga Koalicioni rekomandojnë që individët të cilët dëshirojnë të inkuadrohen në këto momente së pari të informohen se si ta bëjnë këtë. Organizatat të cilat janë pjesë e Koalicionit mbeten të hapura për partneritet, e po ashtu mbështesin bashkim në zbatimin e aksioneve, duke përfshirë edhe qasje të përbashkët para donatorëve të ushqimit.



# Shpirt skautësh për kapërcim më të lehtë të vetë izolimit

Terarium, maskë mbrojtëse, mini llogore, vula, ndarëse për libra dhe kropa janë vetëm pjesë e punëve interesante të cilat këto ditë i punuan skautët nga Njësi i parë skautësh të Shkupit (PSIO). Gjatë pandemisë ata shpikën online sfidë për të gjithë skautët dhe emblemë të re skautësh.

Që të marrin pjesë në sfidën, ata duhet të veshin uniforma, ta vendosin shaminë e tyre të skautëve dhe të incizojnë video derisa krijojnë ndonjë prej sfidave të dhëna. Në të vërtetë, programi i skautëve bazohet mbi mësimin e shkathtësive. Pasi që një skaut të fitojë ndonjë shkathtësi duhet t'i kalojë disa rregulla të dhëna paraprakisht dhe të fitojë emblemë të cilin duhet ta qepe në uniformën e tij. Në këtë rast, pjesëmarrësit do ta fitojnë emblemën “Bëje vetë”.

“Është vështirë”, thotë Ivan Velkoski nga PSIO. “Edhe në rrjetet sociale ndjehet kjo nostalgji. I ka marrë malli skautët, dëshirojnë të ankohen mes veti, pasi që ne jemi një familje e madhe”.

Ai e përcjell mesazhin e skautëve deri te të rinjtë që të fillojnë të jenë më të ndërgjegjshëm dhe më me përgjegjësi të sillen ndaj bashkëqytetarëve të tyre dhe të mos i rrezikojnë me dëshirën që të jenë jashtë.



A hand holding a paper airplane against a teal and yellow gradient background. The hand is positioned in the lower-left quadrant, with the fingers gripping the wings of the paper airplane. The paper airplane is oriented towards the upper-right corner. The background is a smooth gradient from teal at the top to yellow at the bottom.

LAJME  
NGA  
**SHOQËRIA CIVILE**

# PJESËMARRJA QYTETARE

## Online resursi i ri për procesin e integritimeve në BE

Shoqata Evrotink – Qendra për strategji evropiane krijoi një vegël digjitale gjithëpërfshirëse për edukim, vëzhgim dhe ndarjen e njohurive dhe informatave lidhur me procesin e qasjes drejt BE-së. Kjo vegël është krijuar në suaza të grantit të tyre të veprimit nga Civika mobilitas.

**QN:** Prej ku ideja për krijimin e platformës <https://eu.org.mk/>

**Evrotink:** Ideja për platformën resurse vjen nga nevoja për një ueb faqe të tillë ku në mënyrë të vazhdueshme do të prodhohë informata nga fusha e integritimeve në BE të Maqedonisë së Veriut. Inspirimi erdhi nga shtetet fqinje të cilat janë në proces të negociatave dhe të cilat posedojnë palë për negociata. Realizimi i saj ishte dëshirë dhe plan afatgjatë, i cili do t'i ndihmojë shoqërisë gjatë procesit të integritimeve në BE, dhe atë përmes informimit dhe edukimit të vazhdueshëm të grupeve qëllimore specifike.

**QN:** Çfarë përmbajtje mund të gjendet në platformë dhe në cilën mënyrë azhurnohet?

**Evrotink:** Përmbajtja e ueb faqes është përbërë prej resurseve, linqeve, videove, dokumenteve, lojërave dhe simulimeve lidhur me BE dhe negociatat për anëtarësim. Shfrytëzuesit mund të informohen për funksionimin e BE, për përparësitë e hyrjes së RMV në BE, për fondet e programeve të BE të cilat mund të shfrytëzohen, si dhe për përvojat e shteteve tjera si Kroacia, Serbia dhe Mali i Zi. Në menynë “Unë dhe BE” vazhdimisht do të azhurnohen temat dhe pyetja e muajit që do të jetë aktuale në momentin e vendosjes në platformë. Po ashtu ka edhe lidhja e muajit, e cila po ashtu është aktualiteti i fundit ose lidhje, dhe ka të bëjë me BE-në dhe negociatat për anëtarësim. Menyja përmban edhe fakte dhe numra për BE-në, të cilat janë të dobishme dhe cilat duhet të dihen, ndërsa do të bëhet edhe publikimi i informatave nga hulumtimet EVROMETAR dhe BAROMETAR.

Po ashtu, rregullisht publikohen informata nga evenimente e fundit të cilat janë organizuar nga ana e Evrotink, ndërsa tematikisht janë të lidhura me BE-në ose kanë ndonjë parashenjë të BE-së.

**QN:** Cilat janë pritjet tuaja nga përdorimi i platformës? Çfarë ndryshimesh prisni të secili nga përdoruesit (qytetarët, trajnuesit, mediat, OQ)?

**Evrotink:** Presim interesim më të madh për temat dhe informatat të cilat do t'i mundësojë ky portal, informim dhe njohuri të qytetarëve për sfidat dhe hapat e ardhshëm nga negociatat me BE-në, sqarim të pozitave dhe rolet e vendimmarrësve, kanalizimi dhe prezantimi i informatave prej dhe për mediat, ndërsa janë lidhur me procesin e negociatave me BE-në informim më i madh për aktivitetet e organizatave qytetare për të gjitha pyetjet e BE-së dhe në përgjithësi, informata për rrjedhën e negociatave të cilat gjenden në platformën resurse.

Presim inkuadrim më të madh në procesin e negociatave nga ana e të gjitha grupeve qëllimore falë informatave të cilat do të jenë të kapshme në këtë platformë, pasi që vetë procesi i aderimit është mjaft kompleks dhe kërkon inkuadrim dhe angazhim të gjithëve.

**QN:** Çfarë është e ardhshmeja? A do të mbindërtohet platforma dhe si?

**Evrotink:** Platforma do të plotësohet vazhdimisht me informata, ndërsa gjatë muajve të ardhshëm, do të sigurohet edhe shtrirja e saj. Kjo shtrirje do t'i kushtohet kapitullit 24 përmes projektit të financuar nga The Balkan Trust for Democracy, i cili tematikisht do të fokusohet në integritet në BE, negociatat dhe kapitullin 24. Si i tillë është komplementar e këtë projekt.

## PATFORMË RESURSE PËR QYTETARË DHE MEDIA



# Polarizimi radikal i pengon vendimmarrjet e mëdha politike

Partitë politike në vend vazhdimisht insistojnë për polarizim të thellë shoqëror pasi që nga njëra anë jemi “ne” ata të cilët gjithnjë jemi populli i vërtetë, patriotë e vërtetë ose qytetarët e vërtetë të moralshëm dhe virtuoz, përkundur “atyre” mbi të cilët projektohen dhe demonizohen karakteristikat më të ndryshme potenciale negative dhe përjetohen si ndonjë kërcënim. Këtë e treguan rezultatet nga hulumtimi “Diskursi i polarizuar dhe ndikimi mbi polarizimin politik dhe social në shoqërinë maqedonase”, të cilin e zbatoi Instituti për shkenca shoqërore dhe humaniste (ISSHH).

Ana Blazheva nga ISSHH sqaroi se me hulumtimin janë përpjekur që të tregojnë se në cilën mënyrë, të folurit ose fjalimi, mund të kontribuojë drejt thellimit dhe përhapjes së fenomenit të polarizimit, që në kuptimin më të gjerë është kuptuar si “qëndrime të kundërta lidhur me çështje të caktuara politike dhe shoqërore dhe politika të cilat janë përjashtuese dhe të papajtueshme”.


Si shembuj të polarizimit social që i kanë analizuar në hulumtim ajo e përcaktoi gjuhën e urrejtjes pas fitores së KH Vardar, të kënduarit e himnit dhe rezultatet nga Evrovizioni, ku diskursi ekzistues i polarizuar akoma më shumë radikalizohet. “Nga ana tjetër, shton ajo, “kjo i pengon partitë për dialog politik, e ata për shkak të pastërtisë para mbështetësve të tyre janë pamundësuar që të bëjnë vendime të rëndësishme, të mëdha politike për të mirën e përbashkët”.

Në tryezën e rumbullakët, ku si folës ishin ftuar gazetarë, u prezantuan edhe diskutuan veglat efektive për vendosjen e normave dhe rregullave në kontekst të polarizimit radikal në shoqëri dhe u diskutuan modalitetet për ballafaqimin me polarizimin që rritet në shoqëri, rolin e mediave në futjen në kornizë të përshtatshme të diskursit, (de) konstruksioni i fenomenit të armikut politik etj.

Instituti për shkenca shoqërore dhe humaniste – Shkup është shfrytëzues i grantit të veprimt të Civika Mobilitas.

# 10 vjet nga refuzimi nga BE

Instituti për politikë evropiane (IPE) përmes info-grafikut e prezantoi procesin e aderimit të Maqedonisë së Veriut drejt BE-së në 10 vitet e kaluara. Ai i prezanton rekomandimet e Komisionit Evropian për mbylljen e negociatave të aderimit, si dhe vendimet dhe kushtet të cilat i vendos Këshilli i BE-së.



# Propozim Ligji për lojërat e fatit – dy anët e problemit

Lëvizja “Anti bixhoz” nga Tetova një periudhë të gjatë ka ndërmarrë aktivitete të ndryshme, duke përfshirë edhe protesta, me qëllim që të miratohet Ligji për lojërat e fatit dhe lojërat zbavitëse. Kërkesa e tyre kryesore për ndryshimin e Ligjit ka të bëjë me vendet ku mund të punojnë kazinotë, bastoret dhe objektet tjera për lojërat

e fatit. Ata kërkojnë që të largohen së paku tre kilometra nga vendbanimet, e kjo do të thotë sa më larg fëmijëve dhe shkollave.

Përkundër tyre është Asociacioni i bastoreve sportive të Maqedonisë (ABSM), i cili përmes kumtesës për opinionin,

paralajmëroi se me propozim ndryshimet e Ligjit, 7.700 njerëz brenda natës do të mbeten pa punë.

Sipas tyre, ndryshimet e Ligjit aprovohen pa analiza paraprake adekuatë të gjendjes, të implikimeve sociale dhe financiare të cilat do ti shkaktonin. Përveç vendeve të humbura të punës, shteti do të humb edhe 253 milionë euro, të cilat si tatimeve çdo vit derdhen në arken shtetërore. Nga ABSM theksojnë se në vendet anëtare të BE-së nuk ndalohen, por rregullohen në mënyrë cilësore lojërat e fatit.

Nga lëvizja “Anti bixhoz” ndaj kësaj u përgjigjën se shqetësimi i bastoreve për personat të cilët do të mbeteshin pa punë është i rrejshëm, pasi që ata edhe deri tani nuk kanë qenë të brengosur për familjet e shkatërruara. Aktivistët u rekomanduan deputetëve që të vizitojnë ndonjë nga familjet pa shtëpi, të cilat janë viktimë e bastit dhe pastaj të vendosin rreth çështjes për zhvendosjen e këtyre objekteve.

Përndryshe, ABSM është organizatë e cila angazhohet për biznes klimë të volitshme për industrinë, ambient të sigurt për të punësuarit e tyre dhe lojtarët, qasje e përgjegjshme ndaj lojërave të fatit në bastore, si dhe vlera sociale dhe ekonomike në komunitet. Në ABSM anëtarë janë pesë bastoret më të mëdha sportive: Mocart, Sport Life, Zlatna Kopacka, Evrotip dhe Marbet.

## “Map the Gap” aplikacion për pjesëmarrjen lokale qytetare

Sandra Stojanovska dhe Elena Ridova janë studente të Fakultetit të Shkencave të Informatikës dhe Inxhinierisë Kompjuterike (FSHIK), të cilat e dizajnuan platformën Map the Gap, përmes të cilës organizatat qytetare, të rinjtë, sektori afarist dhe institucionet shtetërore bashkë do të mund t'i zgjidhin problemet në komunitetin lokal.

Platforma u prezantua gjatë diskutimit “Teknologjia informatike dhe pjesëmarrja e të rinjve në proceset demokratike në nivel lokal”, ët organizuar nga Shoqata “Federalistët e rinj evropian” (XHEF Maqedonia e Veriut).

Krijuesit thanë se ideja kryesore është që të inkuadrohen të gjitha palët të cilat janë të prekura nga problemet në shoqëri, në një rrjet social. Kjo do të kontribuojë që të lehtësohet komunikimi mes tyre, por po ashtu të shmanget “trokitja në derë të gabuar”.

“Platforma ka katër interfejsa, e qytetari i interesuar e hap urdhëresën sipas profilit të tij dhe e përshkruan problemin e tij. Publikimi do të shihet nga përdoruesit tjerë dhe nëse ndonjë prej tyre është i prekur nga problemi i njëjtë, ai mund ta mbështesë publikimin. Platforma do t'i “nxjerre në sipërfaqe” problemet me mbështetje më të madhe që ato të bëhen të dukshme për institucionet, të cilat janë përgjegjëse”, thotë Ridova.

Për momentin në masë të madhe mungon mendimi dhe inkuadrimi i të rinjve në pushtetin lokal, ndërsa atyre u mungon informata kthyesë, e cila do të dëshmojë se mendimi i tyre është me të vërtetë i rëndësishëm.

“Dëshirojmë ta shfrytëzojmë momentin e miratimit të Ligjit për pjesëmarrje rinore, që ta dëshmojmë angazhimin e institucioneve për inkuadrimin e të rinjve në krijimin e politikave” – thotë Jelena Peroska, sekretare gjeneralë e shoqatës XHEF Maqedonia e Veriut, njëkohësisht edhe koordinatore e projektit “Map the Gap”.

## “Lufto me ne” ditë e hapur në Kriva Palankë

Qytetarët dhe shoqatat e Regjionit planor verilindor kishin mundësinë që të bisedojnë me kryetaren e Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit, Biljana Ivanovska, si dhe me revizorin kryesor shtetëror, Maksim Acevski, gjatë ditës së hapur të Laboratorit hulumtues raportues (IRL) në Kriva Palankë.

Sashka Cvetkovska nga IRL tha se ideja është që t'i inkurajojë qytetarët në nivel lokal të flasin për problemet me të cilat ballafaqohen. Filluan me Regjionin verilindor, pasi që ai i ka të gjitha potencialet për jetë më të mirë, por realiteti është ndryshe.

“Ne i kërkojmë përgjigjet pse nuk jetohe më mirë. Problemet janë në fushën e sundimit të drejtës, të korrupsionit, si dhe siç tha revizori shtetëror, në mosnjohjen dhe mungesën e shkathtësive, të cilat janë pasojë e shkatërrimit të institucioneve tashmë tre dekada. Ne jemi këtu që t'i skanojmë se cila janë problemet, pse po ndodh e gjithë kjo, pse shpërngulen të rinjtë nga Kriva Palanka dhe të luftojmë të gjithë bashkë që të jetohe më mirë”, shtoi Cvetkovska.

Për këtë aktivitet IRL bashkëpunon me institucione të pavarura pasi që qytetarët kanë besim te ato.



## Përfshirja e kërkesave romë në programet zgjedhore partiake

Aktivistët romë dhe intelektualët e iniciativës qytetare “Avaja” e promovuan fushatën e tyre të re “Vota ime – obligimi yt” në prag të zgjedhjeve parlamentare 2020. Ata kërkojnë që partitë politike t’i përfshinë prioritetet e komunitetit rom në programet e tyre politike.

Përfaqësuesit e “Avaja” në këtë periudhë organizuan debate publike me bartësit e listave për deputetë në gjashtë njësitë zgjedhore. Sipas tyre, qasja e tyre do të kontribuojë drejt ngritjes së kulturës politike të votuesve romë dhe ata do të bëjnë zgjedhje të informuar, i cili do të jetë në interes të komunitetit rom.

“Avaja” vendosi strukturë në 17 komuna, të cilat zbatojnë konsultime me komunitetin rom rreth asaj se cilat janë problemet dhe nevojat. Organizuam edhe takime me këshilltarët e dy partive më të mëdha VMRO-DPMNE dhe LSDM, në të cilat ua prezantuam fushatën. Shkojmë në takime edhe me ambasadorë nga vende të ndryshme, ku i theksojmë nevojat e komunitetit rom, që të sigurojmë mbështetje për realizimin e nevojave të komunitetit. Gjatë aktiviteteve zgjedhore, do ta ndjekim gjithë procesin, përmes ekipit për vëzhgim, i cili do të informojë për parregullsitë e mundshme. Që ta ngremë vetëdijen të komuniteti dhe pjekurinë të partitë politike, organizojmë debate publike mes partive politike romë dhe aktivistëve

romë, që të japin llogaridhënie për atë që kanë bërë dhe me këtë të kontribuohet për zgjedhje të informuar në zgjedhjet e ardhshme”, tha Albert Memeti.

“Mbetëm të përkushtuar ndaj kërkesave të komunitetit rom dhe në mënyrë aktive do ta ndjekim procesin e realizimit të premtimeve, duke i përdorur mjetet demokratike”, shtoi Elvis Shaqiri.



## ANGAZHIMI QYTETAR

### Zgjidhje për dhunën ndër moshatare me ndihmën e Forum teatrit të “Megjashi”

Një stuhi emocionesh do t’ju kaplojnë derisa e ndiqni Forum teatrin të Ambasadë së parë të fëmijëve në botë “Megjashi”, me temën dhuna ndër moshatare. Një ndjenjë e zëvendëson tjetrën, ju rritet shqetësimi, dëshironi të ngriheni dhe të intervenoni, dëshironi të thërrisni “jo, kjo që bëni nuk është mirë”... Ndërsa në të vërtetë, kjo është ideja e Forum teatrit, të cilin e quajnë edhe “teatër i angazhuar”, t’ua tregojë situatën reale dhe t’ju mundësojë të merrni pjesë në rrjedhën e tij, të intervenoni në zgjidhjen dhe ta ndryshoni fundin e kësaj situatë.

Në Forum teatrin e “Megjashi” ishin inkuadruar nxënës të shkollave të mesme dhe atë të gjimnazit “Koço Racin” nga Velesi, “Nikola Karev” dhe “Shaip Jusuf” nga Shkupi. Në publik ishin ulur shokët e klasës dhe profesorët e

tyre. Në situatën e parë, e cila ndodhte në një nga klasat, në cilëndo shkollë të mesme, publiku qartë e njohu problemin. Aktorët e luajtën përsëri dhe publikut iu ofrua të intervenojë në ndonjë nga momentet kritike. Aktorët ndryshonin, shtoheshin replikat. Ndjenja e padrejtësisë ia linte vendin dëshirës për drejtësi. Duart e ngritura në publik dhe intervenime të reja. A mundet individit të bëjë ndryshim? Ndoshta vetë jo, por mund t’i inkurajojë të tjerët dhe kështu të krijohet masë kritike, e cila pastaj do ta barazojë fuqinë, duke u dhënë zë viktimave, duke i bërë të dukshëm për të gjithë.

Sipas Ana Bitoljanu nga “Megjashi”, këto janë mënyra kreative të shprehurit të rinjve. Forum teatri është menduar dhe dëshiron të ndikojë ndaj ndryshimeve shoqërore, të

ndikojë ndaj gjërave rreth nesh të cilat nuk na pëlqejnë. Të mos bëhemi vëzhgues pasiv, e as ata që vetëm do të vështrojnë dhe do të kritikojnë, por të përpiqemi të gjejmë zgjidhje të ndryshme për gjërat që na mendojnë”, thotë ajo.

Dhuna ndër moshatare është problem i madh për të cilin nuk flitet aq sa duhet. Të dhënat nga UNICEF prej vitit 2018 tregojnë se 42% të nxënësve të moshës prej 13 deri 15 vjet kanë paraqitur se kanë përjetuar dhunë ndër moshatare. Sa janë ata që nuk e kanë paraqitur? Krahas dhunës fizike më e shpeshtë është ajo psikike, e cila shumë shpesh bëhet me ndërmjetësim të Internetit. Videot dhe fotografitë e publikuara ku ofendohen shokët e klasës mbeten gjatë në “rrjet” dhe janë kërcënim i vazhdueshëm për viktimat.

“Një pjesë e mirë e shkollave përpiqen më shumë të fshehin rast të caktuar, në vend që të veprojnë menjëherë

kur do të ndodhë dhuna, që do të thotë edhe paraqitja, dhe raportimi në kohë dhe të thuhet se po, ka ndodhur dhunë, le të shohim tani e tutje”, sqaron Bitoljanu. Sipas saj, dhuna është normalizuar në shoqërinë tonë dhe rrallë kuptohet seriozisht, që do të thotë se nëse nuk ndodh diçka drastike, çdo gjë do të kalojë.

Prandaj vazhdimisht duhet të përkujtohem sa e rëndësishme është jo dhuna dhe sa e madhe është përgjegjësia për të gjithë ne për ballafaqimin me dhunën.

Forum teatri është pjesë e programit Edukimi paqësor i “Megjashi”, plani vjetor të cilit është mbështetur nga Civika mobilitas.

## Edicioni i nëntë i Engage

Konferenca për aktivizëm shoqëror “Engage” për të nëntën herë i bashkoi aktivistët nga e gjithë bota. Ata folën për rrëfimet dhe aksionet e tyre, por me ide të përbashkët të bëjnë ndryshime pozitive në shoqëri.

Mes 15 aktivistëve të cilën morën pjesë ishin edhe: Saraardini, refugjate gjatë luftës në Siri dhe aktiviste për të drejtat e njeriut; Ena Bendevska dhe Kalia Dimitrova nga platforma Meduza; Fejmi Daut, si dhe kinematograf i filmit dokumentar “Toka e mjaltit”.

Demokracia, ambienti jetësor dhe të drejtat e njeriut ishin temat të cilat për të cilat më së shumti folën panelistët në konferencën e sivjetme. Alina Aflekajlor nga “Grinpis Rumania” potencoi se organizata dëshiron t'i inkurajojë njerëzit që ata ta rritin fuqinë e tyre, pasi që shoqëria civile nuk janë vetëm organizatat, por të gjithë njerëzit në shoqëri. Ajo i inkurajoi të pranishmit që ta zgjedhin kauzën e cila është e afërt me zemrën e tyre dhe të dalin jashtë.

Kiril Przho Arsovski e sqaroi lidhjen mes zjarreve në pyll dhe ngrohjen globale, Katarzhina Pruskeviq e ndau përvojën e vet si gazetar sekret, i cili gjashtë muaj ka kaluar në fermë në Poloni. Besian Mehmeti, foli për arkitekturën moderne dhe si shkollat nga e ardhmja krijojnë mundësi të reja për arsim më cilësor.

Panelistët tjerë u fokusuan në inteligjencën artificiale, DNA inxhinierinë, korrupsionin, demokracinë, ndërsa evenimentin e mbylli Antonio Mihajlov nga “Shkupi prajd”.

Për herë të parë këtë vit, Engejxh e organizuan edhe skenën rinore (ENGAGE Youth), ku të aktivistët e rinj dhe novatorët i ndanë përvojat nga puna e deritanishme.

Ky edicion i Engejxh u mbështet nga National Endowment for Democracy, e organizuar nga Forumi Arsimor Rinor dhe Radio MOF.



## Reagim i organizatës qytetare për rastin “Dhoma publike”

Rasti me grupin e mbyllur “Dhoma publike” në rrjetin Telegram u bë aktual kur opinioni më i gjerë kuptoi se në këtë grup shpërndahen fotografi eksplicite dhe video të vajzave nga i gjithë vendi, një pjesë prej tyre janë të mitur. Nga MPB paralajmëruan hetim të hollësishëm, ndërsa në bisedë janë thirrur administratori dhe krijuesi i grupit.

Një numër i organizatave qytetare reagues rreth kësaj çështje dhe theksuan se veprimet e këtilla nuk i befasojnë pasi që mendojnë se sjellja e këtillë është rezultat i zgjidhjeve të këqija sistemore, injorimi nga ana e “të rriturve” dhe sistemi arsimor.

“Prindërit me panik na drejtohen dhe kërkojnë mbështetje,

pasi që nuk janë të gatshëm t'u përgjigjen problemeve të cilat janë realitet i përditshëm i fëmijëve të tyre. Jo aq shpesh, edhe profesorët kërkojnë mendim dhe ndihmë lidhur me këto tema sepse akoma nuk janë trajnuar dhe nuk kanë njohuri të mjaftueshme si të veprojnë në situata të këtilla komplekse. Kjo është vetëm edhe një shenjë se urgjentisht duhet të vendoset edukimi i obligueshëm gjithëpërfshirës seksual (EGJS)", thonë nga Shoqata HERA, duke e theksuar rëndësinë e arsimit për parandalimin e formave të këtilla të dhunës.

Sipas Urania Pirovska nga Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut, prokuroria këtë radhë duhej të reagojë më shpejt.

## Kur do të fillojmë ta dhurojmë ushqimin e tepërt?

Pronarët e shitoreve për ushqim nuk janë të vetëdijshëm për mundësitë dhe pak e njohin rregullativën për dhurimin e ushqimit. Kjo është një nga gjetjet nga hulumtimi i kryer mes kompanive për distribuim dhe shitje të ushqimit, ndërsa i prezantuar në publikimin "Mos hidhni, dhuroni! Ushqimi është resurs i kufizuar", të cilin e prezantoi shoqata Veprat e vërteta të bamirësisë dhe Gazetarët për të drejtat e njeriut më 26 shkurt 2020 në Shkup.

Hulumtimi është realizuar në periudhën prej tetorit deri në dhjetor 2019 dhe konstatoi se një nga problemet kryesore është mungesa e rregullativës ligjore për shfrytëzimin e tepicës së ushqimit. Sipas gjetjeve, vendi ynë nuk ka stërgji për arritjen e qëllimit 12.3 të Qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm, ku thuhet se çdo shtet duhet ta përgjysojë hedhjen e ushqimit deri në vitin 2030, dhe njëkohësisht nuk ekziston empati ose dëshirë që kjo të bëhet realitet.

"Mendoj se duhet të përjashtohen të gjitha parashtresat. Do të thotë nëse fjala është për të mitur duhet të vërtetohet se cilat janë motivet për atë veprim, nëse ndoshta pas atij të mituri qëndron person i rritur, i cili ndoshta e ka shtyrë ose i ka thënë çfarë të bëjë. Ekziston rreziku edhe nga rrjeti i pedofilëve. Për çdo rast, këtu viktimat janë vajzat", thotë Pirovska.

Po ashtu nga Megjashi e theksojnë mundësinë se mes anëtarëve të grupit ka të rritur të cilët i keqpërdorin fotografitë e ndara dhe i bëjnë shantazh viktimave.

Krahas institucioneve, kompanitë private dhe qytetarët kanë treguar vetëdije të ulët për nevojën nga dhurimi i ushqimit të tepërt dhe humbjes së ushqimit.

Sipas Organizatës për ushqim dhe bujqësi të OKB (FAO), Maqedonia e Veriut gjendet në vendin e tetë në suaza botërore për nga sasia e ushqimit të hedhur sipas numrit të banorëve. Të dhënat të cilat plasohen publikisht flasin se edhe te ne hidhen sasi të mëdha të ushqimit, që ka potencial të ushqejë rreth 13.000 qytetarë me tre racione të në ditë. Nga njëra anë kemi përshtypje se përqindja e lartë e të a.q. tepicë e ushqimit, ndërsa njëkohësisht ka mbi 400.000 qytetarë të cilët kanë problem të sigurojnë ushqim.

Shoqata e qytetarëve për ndihmë të pastrehëve dhe familjeve sociale të rrezikuara dhe individëve "Lubeznost" – Shkup është shfrytëzues i grantit institucional nga programi Civika mobilitas.

# BASHKËPUNIMI

## Fushatë për ndihmë juridike falas

Koalicioni Margjinat dhe Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave (ESE) e filluan fushatën për promovimin e Ligjit për ndihmë juridike falas për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme që të fillojnë procedurë juridike për realizimin e të drejtave të tyre.

Nëse ballafaqoheni me problem juridik dhe nuk keni mjete të mjaftueshme financiare për zgjidhje, ju keni të drejtë për ndihmë juridike falas.

Slogani i fushatës "Mos heq dorë, kërko drejtësi!" u bën thirrje qytetarëve që të kërkojnë mbrojtje për të drejtat e tyre dhe realizimin e drejtësisë përmes rrugës institucionale.

Fushata porositi se shteti mund të sigurojë rritje ekonomike dhe zhvillim, barazi gjinore dhe tejkalimin e varfërisë vetëm nëse sigurohet qasje deri te drejtësia dhe iniciativat për fuqizim juridik.

Në video spotet janë prezantuar grupe të njerëzve të cilët

ballafaqohen me probleme të cilat nuk mund t'i zgjidhin për shkak të fuqisë së dobët ekonomike, mosbesimit në institucione dhe/ose diskriminim sistemor. Fushata bën thirrje për realizimin e të drejtës përmes rrugës institucionale.

Shihni video spotet: <http://www.pravnozajakni.mk/barajpravda/?fbclid=IwAR38UeYMmfWuO46z88V8dBRsXzCeBudUdwBvCUTJtoyA1ibGMm-05weDmCE>



## Marsh për të drejtat e grave dhe të drejtat e studenteve

Me rastin e Ditës ndërkombëtare të gruas, u mbajt për të katërtën herë Marshi për të drejtat e gruas, tradicionalisht i organizuar nga Platforma për barazi gjinore dhe aktivistet për të drejtat e grave, ndërsa për herë të parë i paraprinte Marshi i studenteve. Këtë vit protesta iu përkushtua viktimave të dhunës së bazuar mbi gjini, me moton “Ti nuk je fajtores!”, ndërsa studentet e UQMM si grup i veçantë marshuan nën sloganin #Studentet nuk janë fajtores”.


Në prezencë të qindra pjesëmarrësve ata u tubuan te Sheshi Filipi II, aktivistet e lexuan proklamaten e sivjetme, i cili u nxit nga rasti “Dhoma publike”. “Ne nuk jemi të sigurt! As në rrugë, as në shtëpi, e bile edhe as online. Para do kohe i gjithë opinionin ishte i tronditur nga grupi Telegrama – Dhoma publike ku 13.000 anëtarë kanë ndarë, kanë parë dhe janë përqeshur me materiale, fotografi dhe video me përmbajtje seksuale për femra dhe vajza konkrete pa pëlqimin e tyre. (...) Fjala është për formë mjaft radikale të dhunës së bazuar në gjini, pasojat e së cilës janë mjaft serioze”, thuhet në proklamaten.

Mes kërkesave të aktivisteve janë: edukimi gjithëpërfshirës seksual në vend, si dhe parandalim adekuat, me kohë dhe efikas, mbrojtja dhe mbështetja e viktimave të dhunës së bazuar në gjini nga të gjitha institucionet, të cilët janë pjesë të sistemit, si dhe sanksionimi i rreptë i çdo veprimi.

Marshi për të drejtat e grave përfundoi në parkun “Gruaja luftëtare” ku aktivistet e patën performansën finale, duke realizuar adaptim të këngës “Dhunuesi je ti!”, që u shndërrua në himn botëror për padrejtësitë dhe dhunën e bazuar në gjini mbi gratë.

Protesta e studenteve, i parapriu në ditën të shqiptimit të dënimit me burg për tre profesorët dhe një demonstratori nga Fakulteti Ekonomik për shkak të mitë marrjes dhe kërkesës për shërbime seksuale nga studentet për nota.

“Nuk mund të kërkojmë inkuadrim të plotë të gruas në shoqëri si të barabartë, si njeri, nëse procesi arsimor vazhdimisht i kërcënohet, nga arsimit fillor e deri te ai sipëror. Koha është të qëndrojmë bashkë dhe t'i kundërvihemi të gjithë atyre të cilët lejuan ta kalojnë kufirin e autoritetit të vet, koha është që t'i kundërvihemi të gjithë atyre që mendojnë se gratë janë vetëm për shkaqe estetike dhe të gjithë atyre që mendojnë se ne nuk jemi në pozitë që të themi “JO”. Koha është që t'ua zgjatim dorën kolegeve, t'u bashkëngjitëm në luftën dhe t'u ndihmojmë që të dëgjohet zëri i tyre”, qëndron në mesazhin e marshit studentor të 8 Marsit.



# AMBIENTI MUNDËSUES

## Forumi regjional për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë për shoqërinë civile

“Sektori civil duhet të jetë shumë më i hapur ndaj nevojave të qytetarëve, e jo të orientohet vetëm drejt donatorëve”, rekomandoi Nikola Bertolini, udhëheqës i sektorit për bashkëpunim në Delegacionin e Bashkimit Evropian në vend, në Forumin regjional për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë për shoqërinë civile, që u mbajt në Shkup më 22 janar të këtij viti.

Ai po ashtu theksoi se nevojitet bashkëpunim më i forcuar me autoritetet lokale dhe se akoma duhet të punohet në financimin shtetëror. “Qëllimi ynë, qëllimi i donatorëve, është që mos jemi të nevojshëm më këtu”, shtoi ai.

Kalinka Gaber, sekretar shtetëror në Sekretariatën për çështje evropiane tha se asnjë shoqëri nuk do të mund të prosperojë e as të ketë avancim pa shoqëri civile të fuqizuar dhe efikase dhe se qeveritë duhet ta kuptojnë këtë. Ajo e përmendi themelimin e Këshillit për bashkëpunim mes Qeverisë dhe shoqërisë civile dhe theksoi se sektori civil rregullisht merr pjesë në punën e organeve qeveritare.

Në këtë forum morën pjesë përfaqësues nga Shqipëria,

Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia, si dhe përfaqësues të lartë nga Komisioni Evropian dhe nga institucionet publike.

Në këtë forum u prezantuan rezultatet nga Raporti për vlerësim të gjendjes për krijimi e ambientit më të mirë dhe kapaciteteve të shoqërisë civile përkundër Udhëzimit të Bashkimit Evropian për shoqërinë civile në vendet në zgjerim. U prezantua struktura e Instrumentin për ndihmë para aderimit (IPA) për periudhën 2021-2027. Në këtë eveniment u shënuar edhe fillimi i projektit trevjeçar të BE TAKSO 3.



## Organizata qytetare të rrjetëzuara të cilët veprojnë në nivel lokal

Formimi i Rrjetit për demokraci lokale është një nga rezultatet kryesore të projektit trevjeçar “Organizatave qytetare në shërbim të demokracisë lokale”, të cilin e zbatuan Asociacioni evropian për demokraci lokale (ALDA) – Shkup, Shoqata e punëtorëve financiar të vetëqeverisjes lokale dhe ndërmarrjet publike (SHPF) dhe Lëvizja evropiane e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Aktivitetet e realizuara krijuan kushte juridike dhe financiare për organizatat qytetare në nivel lokal; nxitën dhe zhvilluan mekanizma të qëndrueshëm për bashkëpunim mes shoqërisë civile dhe pushtetit lokal; ndërsa po ashtu i fuqizuan kapacitetet lokale të shoqatave me qëllim që të jenë pesë e dialogut qytetare dhe vendimmarrjes në nivel lokal.

Mbi 70 përfaqësues të organizatave qytetare dhe vetëqeverisjes lokale morën pjesë në konferencën përfundimtare “Demokracia lokale – ideal ose praktikë” ku i ndanë përvojat nga projekti, arritjet dhe leksionet e mësuara.

Ivana Petrovska, koordinatore e projektit, theksoi se nevoja për veprim të këtillë vjen nga fakti se organizatat të cilat janë regjistruar në Shkup, shpesh funksionojnë në nivel qendror, derisa sektori civil në qytetet tjera nuk është aspak i zhvilluar. “Mundësuam edhe rrjetëzim të organizatave qytetare në nivel lokal pasi që pamë se në pjesë e madhe prej tyre veprojnë të izoluar dhe në suaza të fushës së tyre” shtoi ajo.

Pasi i vërtetua se një pjesë e madhe prej komunave financiarisht i mbështesin organizatat qytetare në nivel lokal, kanë kërkuar që të zhvillohet standardizimi i mbështetjes, me qëllim që të bëhet në mënyrën më të mirë dhe të jepet efekti i dëshiruar mbi popullatën lokale.



# QYTETARËT PËR NDRYSHIME

Kryeredaktor: Gonca Jakovleska

Redaktor: Aleksandra Siljanovska

Adresa e Botuesit: Rr. Nikolla Parapunov nr. 41a, f.p 55, 10160 Shkup

Tel: ++ 389 (0)2 3065 381

e-mail: [helpdesk@civicamobilitas.mk](mailto:helpdesk@civicamobilitas.mk)



**„Qytetarët për ndryshim“ e boton programi Civica Mobilitas i mbështetur financiarisht nga Agjencioni Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), implementuar nga NIRAS nga Danimarka, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) dhe FCG nga Suedia.**

Artikujt e botuar në këtë revistë shprehin pikëpamjet e autorëve dhe/ose organizatave që kontribuojnë në revistë, por jo ato të Ambasadës Zvicerane/Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim ose ato të organizatave implementuese: NIRAS, MCMS ose FCG.

[www.civicamobilitas.mk](http://www.civicamobilitas.mk)